



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë

Drejtuar: Znj. Albulena Haxhiu, ministre
Ministria e Drejtësisë

Znj. Dafina Gexha Bunjaku, u.d. ministër
Ministria e Shëndetësisë

Z. Milazim Gjocaj,
Drejtor i Departamentit të Shëndetësisë në Burgje

Z. Sami Gashi, zëvendësueses i drejtorit të përgjithshëm të
Shërbimit Korrektues të Kosovës

Z. Jeton Mehmetaj, drejtor
Qendra e Paraburgimit në Pejë

Kopje: Znj. Duda Balje, kryetare
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të
Pagjetur dhe Peticione

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 16 nëntor 2022

Qëllimi i vizitës

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin (në tekstin e mëtejshëm: MKP) i Avokatit të Popullit, më 7 korrik 2022, e ka vizituar Qendrën e Paraburgimit në Pejë (në tekstin e mëtejshëm: QPP). Qëllimi i vizitës ishte vlerësimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të MKP-së të dërguara përmes raportit me rekomandime më 3 shtator 2021.¹

Bashkëpunimi me MKP-në gjatë vizitës

Gjatë vizitës së MKP-së në QPP, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK) dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat e QPP-së. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues.

Ekipi i MKP-së gjatë vizitës u njoftua nga drejtoria se kapaciteti i QPP-së është më 80 shtretër dhe momentalisht janë të akomoduar gjithsej shtatëdhjetekatër (74) të burgosur, prej tyre nëntë (9) të dënuar dhe gjashtëdhjetepesë (65) të paraburgosur.

Keqtrajtimi fizik

MKP-ja, gjatë vizitës në QPP, ka intervistuar një numër të konsiderueshëm të të paraburgosurve dhe të të dënuarve dhe nuk ka marrë asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. Po ashtu nuk ka marrë asnjë ankesë lidhur me sjelljet e zyrtarëve korrektues, të cilat do të përbënin trajtim që nuk është në pajtim me respektimin e dinjitetit njerëzor të të burgosurve. Gjatë vizitës është vërejtur komunikim interaktiv dhe miqësor ndërmjet personelit korrektues dhe të burgosurve.

Ekipi monitorues gjatë vizitës në QPP u interesua për të kuptuar më shumë lidhur me trajtimin nga Policia e Kosovës e të paraburgosurve nga pjesëtarët dhe për respektimin e të drejtave të tyre themelore, që nga momenti i arrestimit. Të gjithë të paraburgosurit e intervistuar kanë pohuar se janë trajtuar në mënyrë korrekte dhe profesionale nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe se janë respektuar të drejtat e tyre themelore.

Kushtet e akomodimit

MKP-ja, edhe gjatë kësaj vizite, ka marrë ankesa të shumta nga të paraburgosurit dhe nga të dënuarit, lidhur me kushtet e akomodimit në QPP. Të burgosurit e intervistuar pohuan se në dhomat ku janë të akomoduar ka shume lagështi. Për t'i vërtetuar pohimet e tyre, MKP-ja ka vizituar dhomat në krahun B në QPP dhe ka vërejtur se pohimet e tyre qëndrojnë, pasi në këtë krah kishte mjaft lagështi. Ekipi i MKP-së po ashtu ka pranuar ankesa të shumta nga të burgosurit për mungesën e hapësirës në QPP dhe për ndriçimin natyral dhe artificial.

MKP-ja konstaton se kushtet e akomodimit në QPP, në kuptim të hapësirës për të burgosurit, ndriçimit natyral dhe artificial, nuk janë në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP) e as me standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (KPT).

¹ MKP, Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, publikuar më 3 shtator 2021. Për më shumë shih: <https://oik-rks.org/2021/09/04/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-peje/>

Kujdesi shëndetësor

Gjatë vizitës, MKP-ja nuk ka marrë ankesa lidhur me kujdesin e ofruar shëndetësor nga njësia shëndetësore në QPP. Shërbimet shëndetësore të cilat nuk mund të ofrohen në QPP, ofrohen në institucionet e tjera publike shëndetësore.

Gjatë vizitës, MKP-ja ka vërejtur se shërbimi shëndetësor për t'i parandaluar vetëvrasjet dhe vetëlëndimet i ndërmer veprimet duke u bazuar në Praktikën Standarde të Veprimit të DShB-së.² Nga dokumentacioni i analizuar, MKP-ja ka vërejtur se në vitin 2022 janë evidentuar 4 vetëlëndime, 4 lëndime trupore, asnjë tentim vetëvrasje, asnjë lajmërim për abuzime seksuale, 5 raste me grevë urie dhe 14 me masë disiplinore të vetmisë.

Sa i përket infrastrukturës së shërbimit shëndetësor në QPP, MKP-ja vëren se gjendja është e njëjtë, përpos që është bërë një ordinancë për stomatologun. Një pjesë e ordinancës stomatologjike shfrytëzohet edhe për laborator, në të cilin bëhen analizat laboratorike bazike nga stafi shëndetësor i mesëm i trajnuar.

Regjimi

Ekipi i MKP-së ka vërejtur se për shkak të infrastrukturës, pavarësisht përpjekjeve të drejtorisë së QPP-së, QPP-ja nuk ka mundësi të ofrojë angazhim në punë, as në aktivitete të mirëfillta për risocializim, e as ndonjë trajnim eventual për të burgosurit. MKP-ja u njoftua se 8 të burgosur janë të angazhuar në punë, 6 prej tyre janë të dënuar, ndërsa 2 prej tyre të paraburgosur.

Në dispozicion të të burgosurve mbeten daljet në ajër të pastër dy herë në ditë nga një orë dhe një tavolinë ping-pongu e vendosur në oborr të QPP-së dhe shikimi i TV-së në qelitë e tyre. Sa i përket TV-së, ekipi i MKP-së pranoi ankesa nga të burgosurit se vetëm tri kanale janë funksionale dhe kërkesë e tyre është që t'u instalohet sistemi kabllor i TV-së. Lidhur me këtë çështje, gjatë vizitës MKP-ja diskutoi me personat përgjegjës në QPP, nga të cilët u informuam se autoritetet e QPP-së kanë bërë kërkesë në ShKK për t'u instaluar sistemi kabllor i TV-së për të burgosurit, mirëpo ende nuk kanë marrë përgjigje nga ShKK.

MKP-ja inkurajon autoritetet kompetente të përpiqen të ofrojnë për të paraburgosurit dhe për të dënuarit një regjim më të pasur me punë, me trajnime dhe me aktivitete të tjera, për aq sa një gjë e tillë është e mundur, duke u bazuar në Kodin e Procedurës Penale³, në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale⁴ dhe në rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (KPT), të publikuara në vitin 2015.⁵

² Praktikën Standarde të Veprimit të Departamentit Shëndetësor në Burgje.

Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/12/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-te-DShB-2019.pdf>

³ Neni 199, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale përcakton si në vijim: “I paraburgosuri mund të kryejë punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t'i lejohej të punojnë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e dëmtojë procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për këtë në marrëveshje me drejtorinë e institucionit.”

⁴ Neni 200, paragrafi 1, i LESP-së, lidhur me angazhimin e të paraburgosurit në punë, përcakton si në vijim: “I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësive ekonomike të cilat gjenden në rrethin e institucionit korrektues përkatës pas marrjes së pëlqimit të gjykatës kompetente.”

⁵ <https://rm.coe.int/16806a1efc>

Kontaktet me botën e jashtme

Kontaktet me botën e jashtme mbeten në nivel të kënaqshëm. Në dispozicion të të dënuarve dhe të të paraburgosurve janë vizitat familjare dhe telefonatat, si dhe vikendet për të dënuarit të cilat i plotësojnë kriteret.

Konstatim

MKP-ja edhe në raportet e kaluara ka konstatuar se kushtet e akomodimit në QPP, në kuptim të hapësirës për të burgosurit, ndriçimit natyral dhe artificial, nuk janë në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP) e as me standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (KPT). Konstatim i cili potencohet edhe në këtë Letër rekomandimi.

Po ashtu QPP-ja u vizitua dy herë nga KPT-ja (në vitin 2007 dhe në vitin 2015⁶). Sa u përket kushteve të akomodimit, KPT-ja, në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2007, këto kushte i përshkruan si shumë të këqija dhe konstaton se madhësia e qelive nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara nga ky komitet⁷. Përveç kësaj, në raportin e KPT-së thuhej se qelitë në QPP nuk kanë ventilim dhe ndriçim të duhur.

MKP-ja po ashtu konstaton se kushtet e punës për personelin mjekësor dhe për stafin korrektues, në kuptim të hapësirës dhe inventarit, nuk janë në pajtim me ligjet në fuqi.

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Drejtësisë:


- Të krijohen kushte dhe hapësirë adekuate të punës për stafin e Qendrës së Paraburgimit në Pejë (stafin mjekësor dhe korrektues), përderisa kjo qendër të jetë funksionale.
- MKP-ja ripërsërit rekomandimin se kushtet e akomodimit për të burgosurit, përderisa kjo qendër është në përdorim, të jenë në pajtim me standardet minimale të përcaktuara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; me standardet e KPT-së; dhe me standardet e tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.
- MKP-ja ripërsërit rekomandimin që Ministria e Drejtësisë ta njoftojë Avokatin e Popullit për planin e saj për Qendrën e Paraburgimit në Pejë në të ardhmen.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet

⁶ Raporti i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës i vitit 2015 <https://rm.coe.int/16806a1efc>

⁷ Raporti i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës i vitit 2007 <https://rm.coe.int/168069727c>

të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit